

Raport lidhur me projektet zhvillimore dhe Linjën e 10-të Hekurudhore për periudhën Qershor 2021.

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS, përveç angazhimeve tjera të përditshme në realizimin e detyrave të parapara një vëmendje të posaçme ia ka përkushtuar edhe projekteve zhvillimore të cilat janë të një rëndësie të veçantë. Projektet zhvillimore të INFRAKOS-it në ekzekutim e sipër gjatë periudhës raportuese janë:

1. Rehabilitimi gjeneral i Linjës së 10-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)
2. Projekt dizajni preliminar për Linjën e 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Prishtinë – Podujevë – Kufiri me Serbinë)
3. Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e Linjës Hekurudhore (Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës)

Rehabilitimi gjeneral i Linjës së 10-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)



Gjatë muajit Qershor 2021, është zhvilluar një numër i konsideruar i aktiviteteve rreth vazhimit të punëve për rehabilitimin e fazës së parë të Linjës së 10-të hekurudhore në disa fronte pune përgjatë kësaj linje hekurudhore, dhe se në total në seksionet e mëposhtme kemi 21.85 km , binarë të instaluar në seksionin Fushe Kosove deri në Gurrëz dhe 470 m afër Stacionit Hani i Elezit , me çka konstatohet se nga 79.57 km kemi të përfunduar 21.85 km apo (27.46%) si binarë në linjën kryesore dhe dytësore së bashku. Në dritare pune prej 10 orësh janë shtrirë 162m, binarë, ndërsa të gjitha gjatësitë e tjera u ndërtuan në kushte të plota ndërprerjeje.

Për të gjitha punët e superstrukturës, Kontraktuesi duhet të vazhdojë me kryerjen e punimeve përfundimtare, formimin e profilin të Ballastit, kontrollin e gjeometrisë së shtrirjes, kontrollin e të dhënave të trasesë dhe stabilizimin. Prandaj, ato punë janë akoma në pritje për t'u kryer.

Punët e kryera në muajin e raportimit janë të përmbledhura si në vijim:

Nr	Segment / Stacioni	Fillimi	Fundi	Gjatesia (m)	Përshkrimi i punës të kryera këtë Muaj
1	Fillimi - FK	246+888	248+200	1,312	
2	Stacioni FK	248+200	249+600	1,400	
3	FK - Miradi	249+600	250+725	1,125	
4	Stacioni Miradi	250+725	252+723	1,998	
5	Miradi - Lipjan	252+723	261+338	8,615	Dy segmente të linjës kryesore (me gjatësi 162,0 m),
6	Stacioni Lipjan	261+338	262+282	944	Binari No IV, rrjeti i kullimit ndërmjet Binarit I dhe Linjës Kryesore ,
7	Lipjan - Bablak	262+282	270+859	8,577	Strukturat hyrese dhe dalese të Leshesave C021-C025, parafabrikimi të leshesave C031, C032 & C033,
8	Stacioni Bablak	270+859	271+606	746	
9	Bablak - Ferizaj	271+606	280+731	9,126	
10	Stacioni Ferizaj	280+731	281+937	1,205	Muri mbajtës majtas W12-L, argjinatura në tranzicion e Murit W12-L, rrjeti kullues,
11	Ferizaj - Gurez	281+937	288+994	7,057	Kanali kullues trapezoid (nën NCR), strukturat e hyrjeve dhe daljeve nga lëshesat C050, C052 në C060, hyrjet dhe dalja në Ura B09, muri mbajtës W16-L (përfundimi i strukturës),
12	Stacioni Gurez	288+994	289+778	784	Platforma Gurez, Binari No I (punime tokësore), Binari No III (superstruktura 620 m), rrjeti kullues midis binarit I dhe linjës kryesore
13	Gurez - Kacanik	289+778	299+740	9,962	Platforma në ndalesën Metalurgjia, Platforma në vend-ndaljen 294+900
14	Stacioni Kacanik	299+740	300+608	868	
15	Kacanik - HiE	300+608	311+174	10,566	
16	Stacioni HiE	311+174	311+954	781	
17	HiE -Fundi	311+954	313+711	1,756	
Gjatesia Totale =				66,823	

Kontraktori ndaloi dorëzimin e Ballastit nga 1 furnizues pas dështimeve në gradim dhe në cilësinë e gurit. Prandaj tani kemi vetëm 2 burime të ndryshme të aprovuara për furnizimin me Ballast . Plani i Inspektimit dhe Testimit (ITP) për Ballast u ra dakord me NjiP dhe miratimi u dërgua në 03/03/2021. Më 21/05/2021 Kontraktuesi paraqiti për miratim një furnizues tjetër nga Maqedonia e Veriut (Pisenik Ltd) por miratimi nuk mund të lëshohej për shkak të dokumentacionit jo të plotë.

Përderisa po vazhdon me shpërndarjen e traversave prej betoni me para-nderje me gjatësi 2.60 m dhe 2.40 m me sistemin e fiksimit në një numër të përgjithshëm rreth 60,580 copë (46.018 copë të

certifikuar) që përfaqësojnë 47.8% të sasisë totale.

Kontraktuesi ka dorëzuar 159.240 m binarë (98.760 m 60E1 R260 dhe 33.240 60E1 R350 si dhe 27,720 S49 R260) dhe i vendosi ato përgjatë aksit të trasesë.

Çështje të tjera kryesore që ndodhen në këtë muaj:

- NjIP-PIU dhe Mbikëqyrësi patën një takim teknik më 01/06/2021 me praninë e projektuesit të Komunës Ferizaj për të zgjidhur çështjet në lidhje me konfliktet që kishin lindur nga tejkallimet në rindërtimin e rrugëve të Komunës Ferizaj dhe kufijve të Projektit si një vazhdimi i takimeve të mëparshme;
- Një takim me NjIP dhe Kontraktorin u mbajt më 03/06/2021, për të zgjidhur çështjet në pritje për mjedisin;
- Një video konferencë me Bankat u mbajt në 07/06/2021 për të diskutuar progresin e Projektit dhe për të prezantuar diskutimet fillestare dhe parimin e Amendamentit No 3
- U realizua një FAT(Testet e Pranimit në Fabrikë) në fabrikën CINEL, Treviso, Itali më 21 / 06.2021 për të pranuar ndërrueset e tipit UIC-60 300 1/9, dhe se mendimi përfundimtar është në përpunim e sipër;
- Një sasi e konsiderueshme UXO (Mjeteve Eksplozive të Pashpërthyera) nga Lufta e Dytë Botërore u gjeten gjatë gërmimeve në linjë kryesore në afërsi të Lagjes Marigona më 22/06/2021. Punimet u ndaluan për disa ditë dhe përfunduan në atë pjesë në 23/06/2021, edhe transporti i Ferronikelit u ndalua;
- Një takim me KE dhe Drejtorin e Projektit mbajt më 24/06/2021, ku u bë një informim mbi Projektin;
- Bordi i ri i Drejtorëve të Infrakos SH.A. KE , NjIP dhe Mbikëqyrësi patën një takim dhe vizitë në terren më 30/06/2021. Mbikëqyrësi i shpjegoi Bordit të Drejtorëve detajet e Projektit në lidhje me progresin, vonesat, problemet e deritanishme dhe nevojën për Amendamentit No 3

Aktivitetet të cilat janë realizuar nga Kontraktori konsistojnë me punët e dheut me gërmime demontime të binarëve dhe të traversave të vjetra, ndërtimin e mureve mbrojtëse , platformave të udhëtarëve në Stacionet Miradi, Lipjan , vend ndaljen në Hashanaj, stacionin Bablak, Gurrëz, më pas kanalet e kullimit përgjatë trasesë hekurudhore të shoqëruar me lëshesat të llojit kuti betoni dhe ura betoni, si dhe shtrirjen e trasesë së re hekurudhore me traversa dhe binarë të rinj dhe të salduar në një gjatësi 21 km duke përfshirë linjën kryesore dhe atë dytësore në stacione. Në vijim është bërë prezantimi me fotografi i disa nga punët e kryera gjatë kësaj periudhe :

Punët përgatitorë

Kontraktori gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazhduar me pastrimin e terrenit përgjatë linjës kryesore në pjesën e Lagjes Marigona, afër Lipjanit st. 254+947 - 255+225

Pastrimi dhe përgatitja e terrenit në st. 254+947 - 255+225



Deponimi i materialeve

Deponimi i traversave

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë sjell dhe deponua në pjesën e Lagjes Marigona afër Lipjanit, në Stacionin e Gurrëzës dhe afër Hanit të Elezit, 6912 traversa të betonit (5760 traversa me gjatësi $L=2.60\text{m}$ dhe 1152 traversa me gjatësi $L=2.40\text{m}$).

Deponimi i traversave në pjesën e L. Marigona, afër Lipjanit



Deponimi i traversave në Stacionin e Gurëzës



Deponimi i traversave afër Hanit të Elezit



Deponimi i binarëve

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë sjell dhe deponuar nga Stacioni i Gurrëzës në drejtim të Hanit të Elezit binarë të rinj të tipit UIC60 R350 me gjatësi prej 120m. Numri total i binarëve të sjellë me gjatësi prej 120m është 139 copë, që në total janë gjithsej 16,880.00m.

Deponimi i binarëve përgjatë linjës të tipit UIC 60 R350



Deponimi i ballastit të ri

Kontraktori ka vazhduar me sjelljen dhe deponimin e ballastit në Stacionin e Miradisë, në ndalesën e Fuzhlot dhe në Stacionin e Hanit të Elezit.

Deponimi i ballastit në Gurrëz



Punët gjeodezike


Matjet gjeodezike janë realizuar në baza ditore duke përcjellë punët e realizuara në terren. Punët gjeodezike të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe raportuese përfshijnë pjesët afër Lipjanit dhe afër Stacionit të Gurrëzës. Aktivitetet e ndërlidhura me punët gjeodezike përfshijnë:

- Kontrollimi i gjeometrisë së gërmimit përgjatë linjës kryesore në st. 265+280 – 267+027.
- Kontrollimi i gjeometrisë pas largimit të shtresës së ballastit ekzistues përgjatë linjës kryesore në st. 283+840 – 286+460.
- Kontrollimi i gjeometrisë për pjesën e gërmimit shtesë për shtresa përmirësuese në st. 265+740 – 267+027, 267+220 – 268+410, 283+840 – 284+080, 284+460 – 284+660, 284+720 – 286+620, dhe 287+330 – 287+440.
- Kontrollimi i gjeometrisë për shtresën e bazës në st. 264+140 – 264+860, 265+740 – 267+027, 267+220 – 267+660, 267+660 – 268+140.
- Kontrollimi i gjeometrisë për shtresën mbrojtëse në st. 264+140 – 264+860, 265+740 – 267+220.
- Kontrollimi i gjeometrisë së shtresës së sipërme mbrojtëse në st. 266+220 – 268+140, and 283+840 – 288+273.
- Kontrollimi i gjeometrisë së argjinaturës në st. 265+280 – 265+740, and 284+460 – 284+660.
- Kontrollimi i gjeometrisë së gërmimit dhe shtresës së bazës për lëshesat C021 (st. 264+094.84), C027 (st. 267+223.40), C050 (st. 284+080.00), C051 (st. 284+585.35).
- Kontrollimi i gjeometrisë së gërmimit dhe shtresës së bazës për Urën 05 (st. 265+252.80).
- Kontrollimi i gjeometrisë së gërmimit dhe shtresës së bazës për muret mbrojtëse 021-Djathtas (st. 284+730 – 285+190), 016-Majtas (st. 283+550 – 283+809.98).
- Kontrollimi i gjeometrisë së gërmimit për ndalesën në Metalurgji.

Kontrollimi i gjeometrisë për shtresën e bazës



Kontrollimi i gjeometrisë për shtresën mbrojtëse



Punët e dheut

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Kontraktori ka vazhduar me punët e dheut në Stacionin e Fushë Kosovës, në Stacionin e Gurrëzës, dhe përgjatë linjës kryesore në pjesën e L. Marigona afër Lipjanit përgjatë ndërprerjes 10 orësh të qarkullimit të trenit. Këto aktivitete përfshijnë:

- Gërmim
- Përgatitje të fondimit të trupit të hekurudhës
- Vendosja, ngjeshja dhe testimi i shtresës së bazës
- Vendosja, ngjeshja dhe testimi i shtresave mbrojtëse
- Vendosja, ngjeshja dhe testimi i shtresave përmirësuese

Punimet në linjën 3, linjën 1 dhe linjën diagonale në Stacionin e Fushë Kosovës, st. 248+480 - 248+520; 248+500 - 248+620; 248+620 - 248+660
Vendosja, ngjeshja dhe testimi i shtresës mbrojtëse





Vendosja, ngjeshja dhe testimi i shtresës së sipërme mbrojtëse



Punimet në linjën 3 në Stacionin e Gurëzës, st. 289+050 - 289+710
Gërmimi dhe testimi në kuotën e gërmimit



Vendosja, ngjeshja dhe testimi i shtresës së sipërme mbrojtëse përgjatë linjës kryesore
dhe linjës 1 në Stacionin e Gurëzës, st. 289+085 - 289+750



Punimet përgjatë linjës kryesore në pjesën e L. Marigona st. 254+947 – 255+225

Gërmimit




Ngjeshja në kuotën e gërmimit



Vendosja, ngjeshja dhe testimi i shtresës përmirësuese me material nga ballasti ekzistues
i përzier me material 0-63mm




Vendosja, ngjeshja dhe testimi i shtresës së bazës



Vendosja, ngjeshja dhe testimi i shtresës mbrojtëse



Vendosja, ngjeshja dhe testimi i shtresës së sipërme mbrojtëse



Mbi struktura e linjës kryesore

Gjatë kësaj periudhe raportuese Kontraktori ka vazhduar me punimet përgjatë linjës kryesore në pjesën e L. Marigona dhe në Stacionin e Gurrëzës për linjat sekondare.

Këto aktivitete përfshijnë:

- Demontimi i binarëve ekzistues S49.
- Largimi shtresës ekzistues të ballastit.
- Vendosja e shtresës së parë të ballastit.
- Vendosja e traversave të betonit me gjatësi 2.60m dhe binarëve të rinj të tipit UIC 60 përgjatë linjës kryesore, ndërsa në linjat sekondare, traversat e betonit me gjatësi L=2.40m dhe binarët e rinj të tipit S49, si dhe vendosja e lidhëseve.
- Saldimi i binarëve.
- Vendosja e shtresës së dytë të ballastit.

Punimet përgjatë linjës kryesore në pjesën e L.Marigona në st. 254+947 – 255+225

Demontimi i binarëve ekzistues



Largimi i shtresës ekzistuese të ballastit



Vendosja e shtresës së parë të ballastit




Vendosja e traversave të betonit dhe binarëve të përkohshëm




Saldimi i binarëve



Linja e përfunduar



Punimet përgjatë linjës sekondare në Gurëz, st. 289+050 - 289+710



Punët drenazhe

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Kontraktori ka zhvilluar punimet në kanalet drenazhe përgjatë linjës kryesore, po ashtu janë zhvilluar punimet në lëshesat për pjesët e hyrje-daljeve të prezantuara si në tabelën e mëposhtme.

LESHESA DREJTEKENDESHE

Kodi	St.	Celula	Gjerësia e pjesës se poshtme	Prerjet Tërthore Tipike Lartësia
			b	h
			(m)	(m)
C021	264+094.84	2	4.00	1.70
C022	264+394.	1	2.00	1.00
C023	264+882.49	1	2.00	1.00
C024	265+731.73	1	3.00	1.00
C025	266+207.05	1	2.00	1.00
C026	266+544.8	1	2.00	1.50
C027	267+223.4	1	3.00	1.50
C051	284+585.35	1	3.00	2.00
C058	286+989.97	1	2.00	1.00
C059	287+908.7	1	2.00	1.00
C060	288+220.54	1	2.00	1.00

LESHESA GYPORE

Kodi	St.	Celula	Diametër
		n	D
			(m)
C050	284+080	2	0.80
C052	285+314.34	2	0.80
C054	285+515.43	3	0.80
C055	285+666.51	3	0.60
C056	285+718.63	4	0.60
C057	286+621.71	4	0.80

Punët e realizuara janë prezantuar si më poshtë:

- Gërmim
- Vendosja e betonit të varfër
- Vendosja e armaturës
- Vendosja e gypave PVC
- Mbushja me material të imët

- Ndërtimi i pusetave
Gërmimi për kanalin e kullimit ana e djathtë dhe e majtë, pjesa e Gurrëzës



Vendosja e pahive dhe betonimi



Mirëmbajtja dhe trajtimi i betonit



Ndërtimi i hyrje-daljeve për lëshesat C021, C022, C023, C024 and C025



Ndërtimi i hyrje-daljeve për lëshesat C058, C059 dhe C060 dhe lëshesat gypore C050, C052, C054, C055, C056 dhe C057

Vendosja e armaturës



Vendosja e armaturës



Drenazha në Stacionin e Ferizajt



Muret mbrojtëse

Kontraktori ka vazhduar me punimet në ndërtimin e murit mbrojtës 16-Majtas, st. 283+530 – 283+809.98, me gjatësi $L=279.98\text{m}$.

Këto aktivitete përfshijnë:

Vendosja e armaturës dhe pahive

Betonimi


Vendosja e water stop

Përgatitja e fugave dilatuese

Lyerja me shtresë të dyfishtë të bitumunit

Muri mbrojtës 16 – Majtas, st. 283+530.00 - 283+809.98

Vendosja e armaturës dhe pahive



Betonimi



Muri i ndërtuar



Kablloptike

Kablloptike janë hasur në disa vende gjatë gërmimit për kanalet e kullimit në linjën 4, në Stacionin e Gurrëzës

Stacioni i Gurëzës st. 289+050 - 289+710



Rivendosja e kablllove optike st. 288+140 – 288+200



Stacionet dhe ndalesat

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Kontraktori ka vazhduar me punime në ndalesën e Metalurgjisë, st. 291+390.20 – 291+491.20 dhe në ndalesën në Stagovë. Këto aktivitete përfshijnë:

Gërmimi dhe testimi në kuotën e gërmimit

Vendosja, ngjeshja dhe testimi i shtresës së bazës

Vendosja e armaturës për pllakën e poshtme dhe muret e platformës

Punimi i fugave dilatuese

Vendosja e pahive dhe betonimi

Lyerja me shtresë të dyfishtë me bitumen

Ndalesa në Stagovë, st. 294+844.85 – 294+945.90

Gërmimi



Pjesa e gërmuar



Shtresa e bazës



Testimi i shtresës së bazës



Metalurgjia Stop (CH. 291+390.20 - 291+491.20)


Vendosja e armaturës për muret e platformës



Vendosja e pahive



Betonimi



Largimi i pahive



Fugat dilatuese



Mbushja e platformës



Vendosja e armaturës për pllakën e sipërme



Vendosja e armaturës për pllakën e sipërme dhe rampat



Urat

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Kontraktori ka vazhduar me punimet në hyrje-daljet e urës 08, në pjesën e Gurrëzës.

Ura 08

Vendosja e armaturës dhe pahive për hyrje-daljet e urës 08

